



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 05.10. 2017

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 33, paragrafi 5, neni 51 dhe 52 shpallë:

K O N K U R S

Zgjedhje - Rizgjedhje

1. (Një) Hulumtues i pavarur për shek.XIX-XX

Kandidatët për pozitën Hulumtues i pavarur duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Vërtetimin me të cilin dëshmohet që është duke vijuar studimet e doktoratës,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,

- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*”.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetatat ditore, duke filluar nga data 05.10.2017, gjerë më datën 19.10.2017 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, kurse aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza”, pa numër (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).